



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 68

Tiranë – E enjte, 2 prill 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 209, datë 1.4.2026	Për lirim nga detyra.....	5143
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 210, datë 1.4.2026	Për emërim në detyrë.....	5143
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 1.4.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.445, datë 31.7.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për zbatimin e projektit të portit të ri tregtar të integruar të Durrësit në Porto-Romano””.....	5143
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 241, datë 1.4.2026	Për lirim dhe emërimin në detyrë të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.....	5146

**VENDIM****Nr. 209, datë 1.4.2026****PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Andrea Shllaku, zëvendësministër i Mbrojtjes, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 210, datë 1.4.2026****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Pranvera Skana emërohet zëvendësministër i Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 223, datë 1.4.2026**

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.445, DATË 31.7.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË PORTIT TË RI TREGTAR TË INTEGRUAR TË DURRËSIT NË PORTO-ROMANO””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.445 datë 31.7.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për zbatimin e projektit të portit të ri tregtar të integruar të Durrësit në Porto-Romano””, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikat 3 dhe 4, fjalët “... vlera e përgjithshme prej 815 696 300.40 (tetëqind e pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind pikë dyzet) lekësh ...”, zëvendësohen me “... 819 943 380.4 (tetëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e dyzet e tre mijë e treqind e tetëdhjetë pikë katër) lekësh ...”;

b) Në tabelën, bashkëlidhur vendimit, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

i. Të dhënat për shpronësim në nënndarjet me numrat rendorë 54, 55, 56, 57, 58, 60, 61, 62, 63, 67, 71, 73, 76 dhe 77 zëvendësohen përkatësisht me të dhënat në nënndarjet me të njëjtën numër rendor, sipas tabelës që bashkëlidhet këtij vendimi;



ii. Pas nënndarjes me numër rendor 290 shtohet nënndarja me numër rendor 291, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi;

iii. Në paragrafin “Shënim”, në fund të tabelës, fjalët “... negociohet brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.” zëvendësohen me “... negociohet brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e aktit nënligjor për detajimin e metodologjisë së shkëmbimit në natyrë në zbatim të procedurës për shpronësim për realizimin e projektit të portit të ri tregtar të integruar të Durrësit në Porto-Romano.”.

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Portual Durrës.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Portual Durrës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës-Kavajë-Krujë, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA KËRKESA “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME, NË VENDIMIN NR . 445, DATË 31.7.2025, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONE PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT ‘PËR ZBATIMIN E PROJEKTTIT TË PORTIT TË RI TREGTAR TË INTEGRUAR TË DURRËSIT NË PORTO – ROMANO”

	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM											SHËNIMI (Kufizime hipotekore , barrë nbi pasurinë etj.)				
													"ARË"			"TRUALL"			NDËRTESE SOCIAL- EKONOMIKE		"PYLL"				VLERA TOTALE (lekë)			
NR	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose Qyteti	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja a Totale (m²)	"Arë" (m²)	"Truall" (m²)	"Ndërtesë" (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Vlera sipas preventivitet	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)				
	A	B	C	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	T	L	M	N	Y	Z		
54	GLOBAL TRADING COMPANY			SPTALL E	851 7	18/2	ARE	5,200				14	150	5,200	356	1,851,200 0									1,851,200.00			
55	MUHAMMEDI	RIZA	BARDHOCI	SPTALL E	851 7	18/3	ARE	5,200				14	145	5,200	356	1,851,200 0									1,851,200.00			
56	GLOBAL TRADING COMPANY			SPTALL E	851 7	18/4	ARE	5,200				14	152	5,200	356	1,851,200 0									1,851,200.00			
57	GLOBAL TRADING COMPANY			SPTALL E	851 7	18/5	ARE	5,500				14	153	5,500	356	1,958,000 0									1,958,000.00			
58	GLOBAL TRADING COMPANY			SPTALL E	851 7	18/6	ARE	5,500				14	154	5,500	356	1,958,000 0									1,958,000.00			
60	GLOBAL TRADING COMPANY			SPTALL E	851 7	18/8	ARE	5,500				14	156	5,500	356	1,958,000 0									1,958,000.00			
61	GLOBAL TRADING COMPANY			SPTALL E	851 7	18/9	ARE	6,050				14	157	6,050	356	2,153,800 0									2,153,800.00			
62	GLOBAL TRADING COMPANY			SPTALL E	851 7	18/10	ARE	8,700				14	158	8,700	356	3,097,200 0									3,097,200.00			
63	GLOBAL TRADING COMPANY			SPTALL E	851 7	18/11	ARE	8,350				14	159	8,350	356	2,972,600 0									2,972,600.00			
67	NAXHIJE ZEMRIT ZYRA FADIL REMZIJJE ERIGLENT LEONTINA LORISA FATBARDHI ELIOS	BAJRAM VOKË VOK VOK VOKË OSMAN OSMAN MUSLI OSMAN	VOKA HALILAJ CAHANI VOKA PALUSHI VOKA VOKA VOKA VOKA	SPTALL E	851 7	19/4	ARE	5,070				14	220	5,070	356	1,804,920 0									1,804,920.00			
71	FETAH	ISUF	ELEZI	SPTALL E	851 7	19/8	ARE	9,672				15	181	9,672	356	3,443,232 2									3,443,232.00			
73	YLBER	ISUF	ELEZI	SPTALL E	851 7	20/2	ARE	3,696				13	244	3,696	356	1,315,776 6									1,315,776.00			
76	DRITA ARMAND SIBORA KLEVIS LIRIE	SHEFKI ZYLFI ZYLFI ZYLFI ZYLFI	MUÇMATA MUÇMATA MUÇMATA MUÇMATA MUÇMATA	SPTALL E	851 7	20/6	ARE	6,500				22	191	6,500	356	2,314,000 0									2,314,000.00			
77	ALGERT	SUL	VOKA	SPTALL E	851 7	20/9	ARE	17,220				15	145	17,220	356	6,130,320 0									6,130,320.00			
291	FATMIR	ZAIM	MEHMETI	SPTALL E	851 7	20/8	ARE	1500				18	138	1500	356	534,000									534,000.00			
				SHUMA TOTALE																							35,193,448.00	
				EFEKTI FINANCIAR SHITESË																							4,247,080.00	



VENDIM
Nr. 241, datë 1.4.2026

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË DREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË BURGJEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr.81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Klevis Qose, drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve, lirohet nga kjo detyrë.
2. Z. Adriatik Kupi emërohet drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 32 lekë